



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.83/21

94/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k -Prizren dhe OE N.T.SH “Victory Com” & Company Murseli-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë – Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me numër të prokurimit 632-19-7809-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-KK Gjakovë, me datën 10.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k -Prizren dhe OE N.T.SH “Victory Com” & Company Murseli-Gjakovë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë – Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me numër të prokurimit: 632-19-7809-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-KK Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë – Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me numër të prokurimit 632-19-7809-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-KK Gjakovë, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Drini Company& Berisha com” sh.p.k -Prizren dhe OE N.T.SH “Victory Com” & Company Murseli-Gjakovë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k -Prizren dhe OE N.T.SH “Victory Com” & Company Murseli-Gjakovë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesa në OSHP, me 28.01.2021 me nr. 83/21, dhe me datë 01.02/2021 me nr. 94/21 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë – Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me numër të prokurimit: 632-19-7809-2-1-1 iniciuar nga Antoriteti Kontraktues-KK Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 64, 67 dhe 69 të LPP-së, te ankesa me nr. 83/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 94/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë: 18.02.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k –Prizren

Përgjigje në pretendimin nr. 1: Pretendimi i parë ankimor sipas ankesës 83/21 është se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes së për punë të ngjashme. Sqarojmë se ky pretendim ankimorë edhe më herët është trajtuar nga OSHP, ku është rekomanduar AK të kërkoj sqarime për kontrata me OE privat të kërkohej sqarim ose dëshmi si pagesa për kryerjen e shërbimeve. Ne rastin konkret AK ka kërkuar sqarime prej OE të rekomanduar për kontratë ku në sqarime kanë pranuar përgjigje se për ato shërbime të ofruara janë kompensuar jo me pagesa, por me shërbime të ndërsjellta në mes të OE-ve. Për ekspertin shqyrtues ky sqarim i ofruar nga OE nuk është bindës, me gjithë këtë i mbetet panelit shqyrtues që përfundimisht të vlerësoj një gjë të tillë.

Përgjigje në pretendimin nr.2: Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar nuk ka ofruar kontrata pune për 20 punëtorët e kërkuar, Sqarojmë se kërkesë e dosjes ka qenë :

(Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt).

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, përveq listës me emrat e punëtorëve nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar kontratë të punës apo marrëveshje mbi angazhim në këtë projekt, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.3: Sa i përket pretendimit ankimorë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, se i njëjti nuk plotëson kërkesa e dosjes për makinerinë, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar 2 pastrues të borës mini, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.4: Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë, anëtari i grupit ka aplikuar me kompaninë e regjistruar në Kosovë si dhe me kompaninë e regjistruar në Shqipëri, sqarojmë se anëtari i grupit Florida, në certifikatë të biznesit e ka të cekur se "Dega Kosovë", do thotë është degë e kompanisë amë, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.5: Pretendimi ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, se i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes për deklarata tatimore, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, për anëtarin e grupit Florida nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar deklarata tatimore, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë,

Përgjigje në pretendimin nr. 1 : Pretendimi i parë ankimorë lidhur me referencat nga kompani private, ku sipas OE ankues për këtë OE nuk janë pranuar referencat pa transaksione, ndërsa për OE të rekomanduar për kontratë është vepruar ndryshe, do thotë duke ja pranuar referencat nga kompania private edhe pa transaksione.

Ky pretendim ankimor vlerësojmë se është i bazuar, pasi për siç e kemi cekur në përgjigje e pretendimeve të

OE të parë. OE ka deklaruar se me gjithë se nuk kanë pranuar pagesa nga OE, janë kompensuar me shërbime të ndërsjellta. Vlerësojmë se ky nuk është trajtim i barabartë i OE-ve ashtu siç kërkohet me dispozita të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin nr.2: Lidhur me pretendimin ankimorë se makineria e kërkuar nuk është në emër të OE DT Group si lider i grupit, vlerësojmë se sa i përket kapaciteteve teknike/profesionale anëtarët e grupit mund të plotësojnë njëri tjetrin.

Përgjigje në pretendimin nr.3: Lidhur me pretendimin ankimorë se OE të rekomanduar për kontratë i mungon pjesa e makineri, pastrues të borës mini, siç kemi cekur më lart pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi për pastrues të borës mini,

Përgjigje në pretendimin nr.4: Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë në deklaratë nën betim, nuk ka cekur emrin e tenderit e as numrin e prokurimit, kjo është e vërtetë, me gjithë këtë vetë fakti se deklarata nën betim gjendet në ofertë të OE për këtë projekt, kjo nënkupton se deklarata nën betim po ashtu është për këtë projekt, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.5: Pretendimi ankimor se lideri nuk e ka veprimtarinë për këto punime dhe ka tjera aktivitete të licencuar nga ARBK, vlerësojmë se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që veprimtaria e OE duhet të jetë e njëjtë me projektin në fjalë, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.6: Lidhur me pretendimin ankimor se OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë kontratat e punëtorëve, ky pretendim ankimor vlerësojmë se është i bazuar pasi siç kemi cekur më lart pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar kontrata pune ose marrëveshje mbi angazhim në projekt.

Pretendimet ankimorë të Victory Com kundrejt OE Drini Copmpany janë se “OE Drini i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kontratave dhe referencave sepse të gjitha referencat e paraqitura janë të dyshuara dhe do të kërkojmë të verifikohen nga AK MI sepse është një kontratë me dy referenca, referenca 2014-15 po e njëjta është 2016-17, kurse kjo referenca 2016-17 është me kontratë të vitit 2014-15 pretendojmë se është e falsifikuar. Referenca 2, 2017-18 është 260.040.22. Kurse OE Berisha Com ka referencë 58,500.00. Kurse Kontrata e vitit 2018-19 edhe kjo është e dyshimtë sepse edhe ne kemi qenë pjesë e tenderit dhe nuk ka qenë kështu të planifikuara kanë qenë 260,000.00. Kurse e OE ka qenë me çmim total 14,000,00 pra në kontratë ka qenë e lejueshme vetëm 10% i kontratës. Grupi i OE nuk e plotëson makinerinë për pastrimin e borës ku ju mungon makineri:

Pastrues i borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës i vogël mini 2 copa Mungon Kamion transportues për bartjen e borës nga rruga dhe trotualet me peshë totale minimuni 7t 2copa mungojnë. ” OE ankues shpreh dyshim se OE Drini Company ka referenca të falsifikuara, sqarojmë se ekspertit shqyrtues nuk

ka kompetencë e as kapacitet profesional të përgjigjet në pretendime të tilla ankimore, dhe nëse OE ka dyshim/pretendim për falsifikime mendojmë se i njëjti duhet ti drejtohet organeve tjera kompetente. Sa i përket pretendimeve ankimore se OE drini company nuk plotëson kërkesat sa i përket makinerisë, kjo mendojmë se është sqaruar me raportin e ekspertizës dhe vendimin e OSHP-së 638-645/2020, ku është konstatuar se OE Drini plotëson kërkesat sa i përket makinerisë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore ku OE ankues pretendon se i njëjti i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, vlerësojmë se edhe këto pretendime janë trajtuar përmes vendimit 638-645/20, me të cilin rast është edhe raporti ekspertizës 638-645/20 si dhe vendimi i OSHP-së nr.638-645/20 është konstatuar se OE nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket pajisjeve, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve të aprovohen pjesërisht të bazuara, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.02.2021 me raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k -Prizren, me datë 22.02.2021 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë, me datë 23.02.2021 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.02.2021, te mbajtur ne ZOOM në ora 12:30, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit i OE-ve ankuese, përfaqësuesit AK-së nuk ka qenë prezent në seancë, eksperti shqyrtues, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankuese z. Fetoshi i cili deklaroi : ne ju sqarojmë se qëndrojmë në tersi pran pretendimeve tona ankimore që i kemi parashtruar edhe në ankesë dhe njëkohësisht kemi dhen edhe përgjigje ndaj konstatimit të ekspertit shqyrtues ku jemi pajtuar me konstatimet e tij se OE i rekomanduar për kontratë faktikisht është i pa përgjegjshëm dhe në pika të shkurtër do të cekim pretendimet tona duke u mundur që të mos i përsërisim të gjitha ato që janë shkruar në ankesë në konsideroj se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për shkak se nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT në lidhje me dëshmitë ku janë kërkuar që të ofrohen dëshmi kontrata të përfunduara në vlerën 350 mij euro ndërsa në liderin është kërkuar që 60 % të kësaj vlere të ketë dëshmi lideri i konzorciumit në lidhje me këtë kërkesë AK ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me lidhje me një kontratë të cilën e ka pasur të lidhur me një OE të Shqipërisë ku ka ekzistuar një referencë lidhur me këtë kontratë por që dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë dmth nuk janë konform kërkesës sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë dëshmi si qeshtë ofruar transaksionet bankare për të ofruar dëshmi konkrete se kontratë amë emrin mirëmbajtja rutinë dhe dimëror bajram curr fierz u duashaj sheshi i trakteve lekbibaj prej 31.5 km dmth për këtë kontratë nuk është ofruar asnjë transaksion bankar se është përfunduar kjo kontratë mirëpo për qudi OE i rekomanduar për kontratë është mundur ta arsyetojë që këtë kontratë e ka përfunduar me kompensim që realisht me ligjin e prokurimit publik nuk parashihet askund dmth mundësia e kryerjes së punëve me kompensim prandaj në lidhje me këtë kontratë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi konkrete sa i përket vlerës së kërkuar që 60 % të ketë lideri prej vlerës totale 350 mij euro, sa i përket referencës e cila është lëshuar nga kompania florida në referencë shkruan qart se punimet janë kryer në vlerë 205 mij euro kurse në sqarimet që janë dhen thuhet se nuk janë inkasuar asnjë mejt financiar prandaj kjo kontratë është përfunduar me kompenzim gjithashtu OE i reklamuar për kontratë është i pa përgjegjshëm për shkak se në sqarime ka ofruar edhe një listë të tjerë e cila nuk është e njëjtë me listën që e ka dorëzuar me rastin e ofertimit konkretisht në lidhje me kontratën që e cekim e ka vendosur edhe një vlerë tjetër 625 mij euro prandaj ka mos përputhje të listës së kontratës së dorëzuara me rastin e ofertimeve dhe me rastin e kërimit të sqarimeve shtesë këtë pretendim tonin e ka vërtetuar edhe ekspertit shqyrtues me të cilin në realisht pajtohemi plotësisht gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin tjetër se nuk ka dorëzuar deklarata tatimore vjetor për liderin i ka përfuar për vitet 2016 dhe 2017 ndërsa OE Florida i mungojnë të gjitha deklaratat tjera këtë e ka konstatuar është ekspertit shqyrtues me të cilin në realisht pajtohemi me këtë konstatim edhe një pikë tjetër që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm është fakti se i njëjti OE nuk ka ofertuar kontrata të punëtorëve ashtu si qeshtë kërkuar në dosje të tenderit ku janë kërkuar 20 punëtor të angazhuar për këtë projekt dhe si dëshmi janë kërkuar kontrata të listave të personelit dhe kontrata edhe këtë pretendim ose

marrëveshje mbi angazhim këtu realisht mungojnë edhe eventualisht ndonjë marrëveshje për angazhim prandaj kjo krekës prandaj kjo krekës e AK nuk është plotësuar nga ana e OE te rekomanduar për kontratë gjithashtu edhe një pretendim tjetër te cilin ne kemi cekur i cili ka te bëjë me makineritë e OE te rekomanduar për kontratë ky OE nuk e plotëson kërkesën për shkak se nuk ka ofruar dy kamion pre pastrimin e bores me mekanizëm shpërndaras krye dhe dy mini pastrues bor me mekanizëm shpërndaras

Ne vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE ankues se dyte i cili deklaroj prandaj edhe nga ky pretendim i jon kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është plotësisht i pa përgjegjshëm dhe nuk mund të jetë fitues i kësaj kontrate krejt në fund desha të shtoj në lidhje me pretendimet e OE tjetër ankues përkitazi me ofertën tonë ku e ka cekur që ne jemi të par përgjegjshëm se nuk kemi ofruar makineri të mjaftueshme kontrata ose referenca dhe i ka kontestuar në lidhje me këto qeshtje me vendim të panelit nr 638 645 /20 është konstatuar se ne i plotësojmë këto kërkesa parandaj mendojmë se kjo qeshtje është e gjykueshme dhe ne si OE jemi OE i përgjegjshëm duke i plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Kërkojmë nga panelit shqyrtues që të aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe që ky aktiviteti prokurimit të kthehet në rivlerësim .

Ne vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE ankues të dyte i cili deklaroj : pra pretendimet ishin të njëjta me OE ankues për OE të rekomanduar për kontratë , ne kemi bërë ankesë në OSHP se ju do ta gjykoni drejt këtë tender pra është që 3 vjet në OSHP edhe në komune dhe nuk merret asnjë vendim i drejtë deri më tani sa o i përket OE DT Group gjatë qasjes ne kemi pa shumë parregullsi ku ai nuk i plotëson kushtet e as kriteret si lideri pra nuk ka asnjë makineri në pronësi lideri duhet të ketë së paku 60 % të makinerive as nuk ka makineri në referencë e ka e ka bërë në 2016 edhe në atë kohë ne si kompani jemi detyruar që ta largojmë boren sepse ai nuk ka pas asnjë makineri të vetëm pra tenderin e ka pas marrë ashtu si e ka marrë dhe nuk ka pas asnjë makineri për me largu boren . OSHP dy herë na e ka kthyer pretendimin tonë se na kemi bërë ankesë edhe për OE Drini edhe për DT grup dy herë u kthye si pjesërisht e bazuar aneksa jone pra edhe më herët OSHP ka konstatuar se disa pretendimet tona kanë qenë të qëndrueshme edhe janë të qëndrueshme edhe të njëjtën pretendim sikur më herët ky OE DT grup ka shumë parregullsi i mungon deklarata tatimore e mungon edhe makineria mini kamionit gjithashtu i mungon edhe fuqia punëtorë nuk ka as kontratë të punëtorëve në dosje të tenderit ne kemi bërë ankesë në OSHP kur AK e ka shpallur Drini kompani fitues pra edhe pse ishte me e shtrejt edhe pse nuk kishte makineri dhe kish plotë mungesa tjera pra ne kemi bërë ankesë në OSHP dhe OSHP-ja me vendimin 933/19 dhe 952/19 i ka aprovuar të bazuara pretendimet tona ku pretendimet hala të njëjtat sa janë ku OE nuk i plotëson kushtet për makineri se ka shumë pak makineri nëse bëjnë borë në fshat ka me ra edhe në qytet dhe kjo nuk mundet me plosur s'është ka makineri përveç asaj që ka mungesa edhe në dosje të tenderit edhe kjo u kanë me dy lloje lloje i par u kanë Qyteti ndërsa lloji i dytë ka qenë fshatrat këtyre i mungon dy makineri mini dhe kamionë për bartjen e bores me peshë totale mbi 7 ton këto mungojnë këto nuk janë në dosjen të tenderit nuk e di ku i ka pa ekspertin

kto e kam edhe prej juve. Besojmë qe OSHP dot e marr nje vendim te drejt dhe do ta kthej lenden ne rivlerësim ta aprovoj ankese tone si te bazuar dhe ta hudh poshtë ankesën e OE Drini.

Ne fjalën përfundimtare Eksperti deklaroj : qëndroj pran raportit te ekspertizës nuk kam najsen ma shumë me shtu veq kisha dashtë mu ndërlidh se tha u kanë qe ne dosje 60 % me kan te liderit nuk u kanë kërkesë ajo 60% u lyp për kontrata te ngjashme me liderin me pas mirëpo edhe pse nuk u lyp prej liderit ky edhe si konzorcium edhe qysh do koft ka mangësi ne pajisje fituesi sa i përket OE Drini kjo edhe me vendimi te OSHP edhe me ekspertizë paraprahe u konstatua se i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit , kur eshte kthi kjo land AK i ka përgjysmë kërkesat sa i përket pajisjeve jon zvogëlua kërkesat nr i kamionëve nr i punëtorëve krejt .

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k –Prizren, se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes së për punë të ngjashme.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor edhe më herët është trajtuar nga OSHP, ku është rekomanduar AK të kërkoj sqarime për kontrata me OE privat, të kërkohej sqarim ose dëshmi si pagesa për kryerjen e shërbimeve. Ne rastin konkret AK ka kërkuar sqarime prej OE të rekomanduar për kontratë, ku në sqarime kanë pranuar përgjigje se për ato shërbime të ofruara janë kompensuar jo me pagesa, por me shërbime të ndërsjellta në mes të OE-ve. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky sqarim i ofruar nga OE nuk është bindës.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k –Prizren, se OE i rekomanduar nuk ka ofruar kontrata pune për 20 punëtorët e kërkuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes ka qenë:

(Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt).

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, përveç listës me emrat e punëtorëve, nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar kontratë të punës apo marrëveshje mbi angzhim në këtë projekt, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k –Prizren kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, se i njëjti nuk plotëson kërkesa e dosjes për makinerinë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar 2 pastrues të borës mini, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “Drini Company& Berisha Com” sh.p.k –Prizren, se OE i rekomanduar për kontratë, anëtari i grupit ka aplikuar me kompaninë e regjistruar në Kosovë si dhe me kompaninë e regjistruar në Shqipëri, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se anëtari i grupit

Florida, në certifikatë të biznesit e ka të cekur se "Dega Kosovë", do thotë është degë e kompanisë amë, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Drini Company & Berisha Com" sh.p.k –Prizren , kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, se i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes për deklarata tatimore, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, për anëtarin e grupit Florida nuk keni gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar deklarata tatimore, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë
Pretendimi i parë ankimor i OE ankues N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë lidhur me referencat nga kompani private, ku sipas OE ankues për këtë OE nuk janë pranuar referencat pa transaksione, ndërsa për OE të rekomanduar për kontratë është vepruar ndryshe, do thotë duke ja pranuar referencat nga kompania private edhe pa transaksione.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar, ashtu siç është sqaruar në përgjigjen e pretendimeve të OE të parë. OE ka deklaruar se me gjithë se nuk kanë pranuar pagesa nga OE, janë kompensuar me shërbime të ndërsjellta. Vlerësojmë se ky nuk është trajtim i barabartë i OE-ve ashtu siç kërkohet me dispozita të LPP-së.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë, se makineria e kërkuar nuk është në emër të OE DT Group si lider i grupit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se sa i përket kapaciteteve teknike/profesionale anëtarët e grupit mund të plotësojnë njëri tjetrin.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor të OE ankues N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë, se OE të rekomanduar për kontratë i mungon pjesa e makineri, pastrues të borës mini, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues siç e ka cekur më lart, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi për pastrues të borës mini,

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë, se OE i rekomanduar për kontratë në deklaratë nën betim, nuk ka cekur emrin e tenderit e as numrin e prokurimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky konstatim është i vërtetë, me gjithë këtë, vetë fakti se deklarata nën betim gjendet në ofertë të OE për këtë projekt, kjo nënkupton se deklarata nën betim po

ashtu është për këtë projekt, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi i radhës i OE ankues N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë ka të bëjë se lideri nuk e ka veprimtarinë për këto punime dhe ka tjera aktivitete të licencuar nga ARBK, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që veprimtaria e OE duhet të jetë e njëjtë me projektin në fjalë, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor, se OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë kontratat e punëtorëve, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar pasi siç është cekur më lart, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar kontrata pune ose marrëveshje mbi angazhim në projekt.

Pretendimet ankimore të Victory Com kundrejt OE Drini Copmpany janë se OE Drini i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kontratave dhe referencave sepse të gjitha referencat e paraqitura janë të dyshuara dhe do të kërkojmë të verifikohen nga AK MI sepse është një kontratë me dy referenca, referenca 2014-15 po e njëjta është 2016-17, kurse kjo referenca 2016-17 është me kontratë të vitit 2014-15 pretendojmë se është e falsifikuar. Referenca 2, 2017-18 është 260.040.22. Kurse OE Berisha Com ka referencë 58,500.00. Kurse Kontrata e vitit 2018-19 edhe kjo është e dyshimtë sepse edhe ne kemi qenë pjesë e tenderit dhe nuk ka qenë kështu të planifikuara kanë qenë 260,000.00. Kurse e OE ka qenë me çmim total 14,000,00 pra në kontratë ka qenë e lejueshme vetëm 10% i kontratës. Grupi i OE nuk e plotëson makinerinë për pastrimin e borës ku ju mungon makineri: Pastrues i borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës i vogël mini 2 copa, Mungon Kamion transportues për bartjen e borës nga rruga dhe trotualet me peshë totale minimuni 7t 2copa mungojnë.". OE ankues shpreh dyshim se OE Drini Company ka referenca të falsifikuara, Paneli Shqyrtues sqaron se nëse OE ka dyshim/prendim për falsifikime, i njëjti duhet ti drejtohet organeve tjera kompetente. Sa i përket pretendimeve ankimore se OE drini company nuk plotëson kërkesat sa i përket makinerisë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se kjo çështje është sqaruar me vendimin e OSHP-së PSH.nr.638-645/2020, ku është konstatuar se OE Drini plotëson kërkesat sa i përket makinerisë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore ku OE ankues pretendon se i njëjti i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se edhe këto pretendime janë trajtuar përmes vendimit PSH.nr.638-645/20, ku është konstatuar se OE nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket pajisjeve, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimeve dhe shoshitjes së

provave në tërësi, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka apsur parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe me këtë nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë vlerësimit të ketë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe të veproj sipas nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "Komuna e Gjakovës";
- 1x1 OE "Drini Company& Berisha Com" sh.p.k –Prizren;
- 1x1 OE N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.